

**Znj. Selime Bregu** ka përfunduar studimet e larta në vitin 1986 në Degën Financë, Fakulteti Ekonomik në Institutin e Lartë Bujqësor. Në vitin 2011 është certifikuar në kualifikimin Pasuniversitar “Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme” pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.

Karrierën profesionale e ka filluar në Gusht të vitit 1986, me detyra të ndryshme si, ekonomiste, revizore, drejtuese në degë banke, shef finance në institucion.

Në muajin Nëntor 1998 ka filluar punë në KLSH, në pozicionin inspektore në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Institucioneve Financiare. Përgjatë viteve të punës në KLSH ka qenë pjesë e Departamenteve të Auditimit të Buxhetit të Shtetit e Institucioneve Qendrore dhe e Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, në pozicionin Auditues i Parë dhe Auditues i Lartë.

Aktualisht është në pozicionin Kryeaudituese në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Gjatë punës në KLSH ka marrë pjesë në trajnime, konferenca dhe seminare të ndryshme brenda vendit dhe jashtë vendit, si në Londër, Slloveni, Hollandë, Turqi, Poloni, etj., për çështje të auditimit të jashtëm publik, mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, etikën dhe burimet njerëzore në institucionet supreme të auditimit, mbi prokurimet publike, mashtrimin dhe korrupsionin, etj.